27.12.2024

Proçes-verbal i mbajtur sot më datë 27.12.2024, ora 13:00 min, në sallën e mbledhjeve pranë Bashkisë Cërrik. Në mbledhje marrin pjesë Kryetari i Bashkisë Z. Andis Salla dhe këshilltarët:

1- Besnik Binjaku
2- Erona Yjini
3- Jetmir Horoshi
4- Zamira Fahriu
5- Adriatik Belshi
6- Erinda Vishkulli
7- Adi Çepa
8- Burbuqe Sofa
9- Elton Ibro
10- Pranvera Xiçi
11- Asqeri Xibrraku
12- Zegjine Dhepa
13- Qamil Boja
14- Nadire Aslloni
15- Elton Kumrija
16- Flutura Hoxholli
17- Shygyri Xhika
18- Anisa Toki
19- Gazmira Frakulli

Mungojnë: 1- Nandi Plaku
2- Shygyri Kamami

Z. Jetmir Horoshi, kryesuesi i mbledhjes, konstaton se në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e këshilltarëve dhe këshilli i plotfuqishëm mund të vendos.

Kryesuesi: Për këtë mbledhje paraqitet ky rend dite:

1- Pr/Vendim :- "Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2024-2025
2- Pr/Vendim:- Për trajtimin me bursë të nxënësve të Shkollës së mesme Profesionale "Mihal Shahini" Cërrik për vitin Shkollor 2024-2025"
3- Pr/Vendim :- Për trajtimin me bursë të nxënësve që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike, të arsimit parauniversitar, për vitin Shkollor 2024-2025
4- Pr/Vendim ;- "Për shpërblimin dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre."

5- Pr/Vendim: "Për heqjen e procedurave për dhënien në përdorim me ankand të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, në pronësi publike të Bashkisë Cërrik dhe administrimin e disa kontakteve të mëposhtme."

6- Pr/Vendim: - Për nivelin e taksave, e tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2025".

7- Pr/Vendim: "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit Buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 i Bashkisë Cërrik."

8- Jashtë rrodhës:

1- Pr/Vendim: "Për ndryshimin e vendimit nr. 71, datë 27.11.2024" miratimin e ndihmën financiare për familjet në nevojë".

2- Pr/Vendim: "Për miratimin e marrëveshjen në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut për vitin 2025".

3- Pr/Vendim: "Për miratimin e shtesave, banesat e të cilët janë të dëmtuara".

Kryetari: Kush është dakort me rendin e ditës dhe ndryshimet e tij?

Miratohet rendi i ditës me: 19 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Abstenim

Pika 1

Z. Filip Asllani, Përgjegjës pran sektorit të Arsimit, Kulturës dhe Sportit, propozon për miratim e projektit ku të trajtohen me bursë të plotë bazuar në VKM-në nr. 511 datë 27.07.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, për kuotat financiare të ushqimit me mensa dhe konvikte e përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik për vitin mësimor 2024-2025, nxënësit që ndjekin mësimin në vitin e parë në shkollat profesionale, sipas listës emërore bashkëngjitur projektit. Lista përbëhet me 34 nxënës.

Pyetje dhe diskutime?

Znj. Rezgjine Dhepa: - Çfar letrash duhen për të aplikuar?

Z. Filip: - Duhen vërtetim nga shkolla, vërtetim banimi etj.

Miratohet me: 19 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Abstenim

Pika 2.

Z. Filip Asllani propozon për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollës së mesme profesionale "Mihal Shahini", Cërrik për vitin shkollor 2024-2025. Z. Filip: - në shkollën "Mihal Shahini" kemi 32 nxënës që vazhdojnë arsimin profesional. Cërrik. Nxënësit që i përkasin komunitetit Egyptian janë 26 në total. Nxënësit e akomoduar në konvikt janë 6 në total. Me status jetim janë 12 në total.

Pyetje dhe diskutime?

Znj. Gezmira Frakulli: - Çfar kriteresh duhen për të aplikuar këtu?

Z. Filip: - Këtu marrin bursë të gjithë nxënësit që ndjekin shkollën arsimin në shkollën "Mihal Shahini" në Cërrik.

Miratohet me: 19 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Apstenim

Pika 3

Z. Filip :- Na kanë ardhur 20 bursa dhe i kemi ndarë në gjysëm bursa. Në total përfitojnë 40 nxënës. Në Bashki kanë aplikuar 120 nxënës por i kemi l[illegible] tuar. Kemi marrë për bazë nxënësit që i ka ndërruar jetë njëri prind ose të dy, jo të ndarë. Kemi bërë vetëm dy diferencime, për dy nxënës që i kanë braktisur të dy prindrit dhe jeton me gjyshërit.

Znj. Anisa Foçi :- Këtu bëhet fjalë për gjimnazin, shkollën e lartë?

Z. Filip :- Po flasim për tëndëvjeçaren.

Znj. Gazmira Frakulli : Sa është bursa e plotë?

Z. Filip 600 milek dhe këto do të marrin nga 300 mileke.

Miratohet me 19 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Abstenim.

Pika 4

Z. Filip Asllani :- Propozon për miratimin kur ndryshohet vlera e shpërblimit për trajnerin Leonard Toska nga shuma aktuale 50 mijë lekësh në shumën 60 mijë lekësh. Të ndryshohet vlera e shpërblimit për sportistin Enjon Kofsha nga shuma aktuale prej 40 [illegible] lekësh në shumën prej 50 mijë lekësh.

Pyetje dhe diskutime ? S'ka

Miratohet me : 19 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Abstenim

Pika 5

Z. Çerçiz Shabani, Drejtor pranë Zyrës së Bujqësisë, i propozon këshillit Bashkiak Cërrik të miratojnë propozimin për hapjen e procedurave për dhënien në përdorim me ankand të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor, në pronësi publike të Bashkisë Cërrik. Sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullosor që mund të jepen në përdorim mund të jenë si më poshtë :

a) sipërfaqe pyjore
b) sipërfaqe me bimësi pyjore
c) sipërfaqe inproduktive
d) sipërfaqe kullosore / livadh
e) Infrastruktura për kalëne.

Miratimin e procedurën sipas udhëzimit nr. 01, datë 09.06.2016, ankand me prokurim publik.

Miratimin e afatit kohor 10 (vjetë) ujesone (me të drejtë përsëritje) sipas përcaktimeve ligjore.

Amendimin e disa kontratave etj.

Kushtet teknike, dokumentacionin dhe kriteret aplikantëve që do marrin pjesë në konkurim jane të përcaktuar në udhëzimin nr. 01, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit.

Pyetje dhe diskutime ? Ska

Miratohet me 19 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Abstenim

Pika 6

Z. Kleanth Boku, përgjegjës pranë Taksave Bashkinë Cërrik, relaton për këshillin Bashkiak për nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrik për vitin 2025. Z. Boku shtoi se për këtë vitë ndryshimet jane të pakta nga viti i kaluar për taksat e truallit, ndërtesat familjare jane hulur me 10%. Risi këtë vit nuk kemi rritje

të taksave, përkundrazi nga sektori Social me asistencë i kemi përjashtuar nga taksat e tarufflit etj.
Duhet të paguajnë vetëm pastrim, gjelbërim me një vlerë minimale. Për kryefamiljar të vetëm kanë 30% lehtësi
Z. Jetmir Horoshi: S'ka rritje?
Z. Kleant:- Ka rritje, kemi zbritje.
Z. Adriatik Belshi :- Çfarë ndikimi do ketë kjo te Buxheti
Z. Kleanth :- Do ta sjellim drejtorinë së Taksave dhe ata do bëjnë përllogaritje. Kleanthi shtoi se kemi marrë një iniciativë për invalidët e grupit të parë, do lidhim një marrëveshje që do ju japim një kartë dhe brenda territorit të Bashkisë nuk do paguajnë bileta.
Do jenë me abone në territorin e Bashkisë.
Z. Kleanth Boku relaton më në gjerësi në lidhje me projektin e taksave.
Pyetje dhe diskutime të tjera? S'ka
Miratohet me

19 vota Pro
0 vota kundër
0 vota Abstenim

Pika 7.
Z. Hekuran Kumria, Drejtori i Financës, i propozon Këshillit Bashkiak të miratojnë Buxhetin vendor 2025 si më poshtë: 1,1 – Planin e të ardhurave për vitin 2025 gjithsej në vlerën 581,827,147 lekë, sipas tab. nr. 1
1,2 – Planin e të ardhurave afatmesme për vitin 2025-2027, tab 1.1.
1,3 – Detajimi i shpenzimeve për vitin 2025, gjithsej në vlerën 581,827,147 lekë sipas tab nr. 2.
1,4 – Detajimi i shpenzimeve afatmesme për vitin 2025-2027 sipas tab. nr. 2.1.
1,5 – Detajimi i shpenzimeve Operative në Buxhetin 2025 sipas tab nr. 3.
16 – Detajimi i investimeve në Buxhetin 2025-2027, sipas tab. nr. 4.
17 – Buxheti i Këshillit Bashkiak, pjesë integrale e Buxhetit të Bashkisë sipas vendimit nr. 70, datë 27.11.2024.
1.8 – Buxheti i Bashkisë për mbështetjen e shtresave në nevojë, familjeve me aftësi ndryshe, e grave të dhunuara në shumën 4,896,553 lekë.
1.9 – Të miratojë si pjesë e integruar e Buxhetit të Bashkisë, Buxhetin për komunitetin Romë dhe Egjyptian në shumën 7490000 lekë.
2 – Planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitin 2025 në shumën 34,633,610 lekë, e barabartë me 30.13 % të totalit të detyrimeve ose 5.93 % të Buxhetit 2025.
3 – Numri maksimal të punonjësve të bashkisë Lezhë për vitin 2025.
4 – Kuota e pjesmarrjes në KQ në masën 1% të të ardhurave vendore.
5 – Pagesat e këshilltarëve në masën 10% të pagës së Kryetarit.
6 – Pagesa e kryepleqëve në masën 10% të pagës së Administratorëve.
7 – Kuota e pjesmarrjes në shoqatën e Bashkive 0,02% të shpenzimeve Administrative.
8 – Kuota për ngritjen dhe funksionin e Akademis së pushtetit vendor në shumën 251,774,00 lekë.
9 – Të planifikojë jo më pak se 4% të transfertës së pakushtëzuar për fondin e emergjencave.
10 – Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë etj:
Pyetje dhe diskutime?

Z. Getmir Doroshi :- Dëgjesat publike i kemë nëpër gjithashtu kompreku dhe zonat nga ofën. Të gjithë njerzit vuajnë për rrugë arash, qi i kemi mam parasysh
Z. Hekuran :- Ky vit që vjen është orjentuar në rrugë, kanale, mirmbajtje rrugë arash. Një kollogar -tur të prekim të gjitha njësitë.
Znj. Gazmira Faokulli :- Megjënse ka një shpërndarje gjeografike. Sa janë shpenzimet për mallrat
Z. Hekuran :- Mallrat ka OSHE, ujësjellës, Bujqësi Prita etj. Për tu investuar.
Z. Adriatik Belshi :- Te projektet duhet të kishte sa më shumë Buxhet. Që të kemi projekt të gatshme
Znj. Zamira Fahriu :- Për rrugët brenda lagjeve në Fermë, shum problem, rishikojeni.
Znj. Enona Yjini :- Kopshtet me drekë parashikoj
Z. Shygyri Xhika : 50% e takave bosh, kanalet ka use shum keq.

Miratohet me 16 vota Pro
0 vota Apstenim
3 vota kundër.

Pika 8

Z. Hekuran Kumria :- i propozon këshillit të miratojë një ndryshim vendimi nr. 71, datë 27.11.2024, ku kemi miratuar ndihmën financiare për Hysnie Toulant Randle në shumën 20000 lekë, Kërkojnë që ne bëjë të dhe për shkak dokumentacioni ndihma financiare të jepet
Z. Denis Adrian Qokeli, bashkëshorti të zonjës Hysnie
Miratohet me 19 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim

Pika 9

Z. Hekuran Kumria :- Propozoi të miratohet Marrëveshja e Bashkëpunimit me Këshillin e Qarkut për Bashkë-financimin e projektit të rikonstruksionit dhe adaptimit të kohit të parë të ish Ambulancës në Qëndren Rinore.
2- Fondi limit për projektin është 9,976,172 lekë me Tvsh.
3- Financim nga Këshilli i Qarkut 6,000,000,00 lekë ose 60%.
4- Financim i Bashkisë Cërrik 3976172 lekë ose 40%
5- Të rritet limiti i përdorimit të të ardhurave të Bashkisë për vitin 2025, me 6,000,000,00 lekë.
6- Të rritet plani i shpenzimeve nga të ardhurat për vitin 2025 me 6,000,000,00 lekë.
Pyetje dhe diskutime ? S'ka
Miratohet me 19 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim

Pika 10

Z. Hekuran Kumria i propozon këshillit të miratojë ndihmën financiare për riparimin e ndërtesave të tyre Qytetarëve në nevojë si më poshtë:
1. Adelajda Kostniot Hema në shumën 1200000 lekë
2. Rozana Sulejman Lela në shumën 400000 lekë
3. Jani Filip Rrusha në shumën 400000 lekë
Financimi të sigurohet nga transferta e kushtëzuar 2024, kodi i produktit 91707AB.
Shuma totale 2000000 lekë.
Pyetje dhe diskutime ? S'ka
Miratohet me : 19 vota Pro
0 vota Kundër
0 vota Apstenim

Kryesuesi :- Duke ju falenderuar për pjesmarrjen dhe duke ju uruar një vit të mbarë për të gjithë ju, mbledhjen e fundit për këtë vit e deklaroj të mbyllur. Në këtë mbledhje u miratuan 10 (dhjetë) vendime. Mbledhja përfundoi në orën 16:20 min.

Sekretare e Këshillit Bashkiak
Falije Asllani

Fatmir Laroshi

Erolda Gjini

Besmir Brajola

Burbuqe Gafo

Adriatik Sefaj

Pranvera Liçi

Zamira Fahriu

Flutura Hoxholli

Gazmira Frokulli

Zegine Dhepa

Qamil Boçi

Hole Cepa

Nadire Asllani

Eltjon Jano

Agron [illegible]